

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të pjesëve III dhe IV si dhe nenin 135 të Ligjit Nr. 08/L-328 për shërbime të pagesave dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/03, maj 2013), dhe neni 24b paragrafi 15 i Ligji nr. 03/L -333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-096 Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR TRANSAKSIONET E KREDITIT DHE TRANSAKSIONET PËR DEBITIMET DIREKTE NË EURO

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton kërkesat për transaksionet e kreditit dhe të debitimit direkt të kryera në valutën Euro brenda Kosovës dhe ndërmjet Kosovës dhe zonës SEPA, ku si OSHP-ja e pagesit ashtu edhe OSHP-ja e përfituesit janë të vendosura në Kosovë ose një nga OSHP-të ndodhet në Kosovë dhe tjetri brenda zonës SEPA, ose ku i vetmi OSHP i përfshirë në transaksionin e pagesës ndodhet në Kosovë.

Neni 2

Përjashtimet

1. Kjo rregullore nuk zbatohet për sa vijon:
 - 1.1. transaksionet e pagesave të kryera ndërmjet dhe brenda OSHP-ve, duke përfshirë agjentët ose degët e tyre, për llogari të tyre;
 - 1.2. transaksionet e pagesave të procesuara dhe të shlyera përmes sistemeve të pagesave me vlerë të madhe, duke përjashtuar transaksionet e pagesave të debitimit direkt të cilat pagesi nuk i ka kërkuar në mënyrë eksplicite të procesohen nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të madhe;
 - 1.3. transaksionet e pagesave nëpërmjet një karte pagese ose pajisjeje të ngjashme, duke përfshirë tërheqjet e parave të gatshme, përveç rastit kur karta e pagesës ose një pajisje e ngjashme përdoret vetëm për të gjeneruar informacionin e kërkuar për të kryer drejtpërdrejt një transfertë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar nga BBAN ose IBAN;

- 1.4. transaksionet e pagesave të procesuara me anë të çdo pajisjeje telekomunikacioni, dixhital ose TIK, nëse transaksione të tilla pagese nuk rezultojnë në një transfetë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar përmes BBAN ose IBAN;
 - 1.5. transaksionet e dërgesave të parave të përcaktuara në nënparagrafin 1.21 të paragrafit 1 të nenit 4 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.6. transaksionet e pagesave që transferojnë para elektronike, përveç rasteve kur transaksione të tilla rezultojnë në një transfetë krediti ose debitimi direkt drejt dhe nga një llogari pagese e identifikuar përmes BBAN ose IBAN.
2. Kur skemat e pagesave bazohen në transaksionet e pagesave me transfertë krediti ose debitime direkte, por kanë veçori ose shërbime shtesë opsionale, kjo rregullore zbatohet vetëm për transfertat e kreditit ose debitimet direkte.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, dhe përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - 1.1. **transferi i kreditit** - nënkupton një shërbim pagese kombëtare ose ndërkufitare për kreditimin e llogarisë së përfituesit me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së një paguesi nga OSHP-ja që mban llogarinë e pagesave të paguesit, bazuar në një udhëzim të dhënë nga paguesi;
 - 1.2. **debitim direkt** - nënkupton një shërbim pagese kombëtare ose ndërkufitare për debitimin e llogarisë së pagesave të një paguesi, ku një transaksion i pagesës iniciohet nga i paguari bazuar në pëlqimin e dhënë nga paguesi për të paguarin,
 - 1.3. **kanali i inicimit të pagesës** - nënkupton çdo metodë, pajisje ose procedurë përmes së cilës paguesit mund të vendosin urdhërpagesa me OSHP-në e tyre për një transferim krediti, duke përfshirë bankingun në internet, një aplikacion bankar celular, një makineri të automatizuar bankar ose në ndonjë mënyrë tjetër në mjedisin e OSHP-së;
 - 1.4. **emri i përfituesit** - nënkupton, në lidhje me një person fizik, emrin dhe mbiemrin dhe, në lidhje me një person juridik, emrin tregtar ose juridik;
 - 1.5. **OSHP** - nënkupton Ofruesin e Shërbimit të Pagesave;
 - 1.6. **Pagues** - nënkupton një person fizik ose juridik që mban një llogari pagese dhe lejon një urdhërpagesë nga ajo llogari pagese, apo kur nuk ka llogari pagese, një person fizik ose juridik që bën një urdhërpagesë në llogarinë e përfituesit;
 - 1.7. **përfituesi i pagesës/i paguari** - nënkupton një person fizik ose juridik i cili është pranuesi i synuar i fondeve që kanë qenë objekt i një transaksioni pagese;
 - 1.8. **sistemi i pagesave** – nënkupton një sistem të transferimit të fondeve me marrëveshje formale dhe të standardizuara dhe rregulla të përbashkëta për procesimin, kliringun dhe/ose shlyerjen e transaksioneve të pagesave;
 - 1.9. **Skema e pagesave** - do të thotë një grup i vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzuesish zbatimi të rënë dakord ndërmjet OSHP-ve për ekzekutimin e transaksioneve të

pagesave brenda Kosovës dhe në të gjithë zonën e SEPA-s, dhe që është e ndarë nga çdo infrastrukturë apo sistem pagese që mbështet operimin e saj;

- 1.10. **PShP** - ose “përdoruesi i shërbimit të pagesave” nënkupton një person fizik ose juridik që përdor një shërbim pagese në cilësinë e paguesit ose përfituesit të pagesës;
- 1.11. **BBAN** - nënkupton një identifikues të numrit të llogarisë së pagesës, i cili në mënyrë të qartë identifikon një llogari individuale pagese me një OSHP në Kosovë dhe që mund të përdoret vetëm për transaksionet kombëtare të pagesave, ndërsa e njëjta llogari pagese identifikohet nga IBAN për transaksionet e pagesave ndërkufitare;
- 1.12. **IBAN** - nënkupton një identifikues të numrit të llogarisë ndërkombëtare të pagesave, i cili identifikon qartazi një llogari individuale pagese, elementet e së cilës janë të specifikuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO);
- 1.13. **BIC** - nënkupton një kod identifikues biznesi që identifikon qartazi një OSHP, elementët e të cilit janë të specifikuara nga ISO;
- 1.14. **Standardi ISO 20022 XML** - nënkupton një standard për zhvillimin e mesazheve financiare elektronike siç përcaktohet nga ISO, që përfshin paraqitjen fizike të transaksioneve të pagesave në sintaksë XML, në përputhje me rregullat e biznesit dhe udhëzimet e zbatimit të skemave të Kosovës ose SEPA për transaksionet e pagesave që janë objekt i kësaj rregulloreje;
- 1.15. **sistemi i pagesave me vlerë të madhe** - nënkupton një sistem pagese qëllimi kryesor i të cilit është procesimi, kliringu ose shlyerja e transaksioneve të pagesave të vetme me prioritet dhe urgjencë të lartë, dhe kryesisht me shuma të mëdha;
- 1.16. **data e shlyerjes** - nënkupton një datë në të cilën detyrimet në lidhje me transferimin e fondeve shlyhen midis OSHP-së së paguesit dhe OSHP-së së përfituesit të pagesës;
- 1.17. **arkëtim** - nënkupton një pjesë të një transaksioni të debitimit direkt duke filluar nga inicimi i tij nga përfituesi i pagesës deri në përfundimin e tij përmes debitimit normal të llogarisë së pagesës së paguesit;
- 1.18. **mandat** - nënkupton shprehjen e pëlqimit dhe autorizimin e dhënë nga paguesi për përfituesin e pagesës dhe (në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet përfituesit të pagesës) për OSHP-në e paguesit për t'i lejuar përfituesit të pagesës të iniciojë një arkëtim për debitimin e llogarisë së specifikuar të pagesës të paguesit dhe për të lejuar OSHP-në paguesit të jetë në përputhje me udhëzime të tilla;
- 1.19. **sistemi i pagesave me vlerë të vogël** - nënkupton një sistem pagesash qëllimi kryesor i të cilit është procesimi, kliringu dhe shlyerja e transfertat e kreditit ose debitimet direkte, të cilat janë kryesisht të një shume të vogël, dhe që nuk është një sistem i pagesave me vlerë të madhe;
- 1.20. **transaksion pagese ndërkufitar** - do të thotë një transaksion pagese i iniciuar nga një pagues ose nga një përfitues pagese ku njëra nga OSHP e paguesit dhe OSHP e përfituesit të pagesës është e vendosur në Kosovë dhe tjetra në një lokacion tjetër jashtë Kosovës, por brenda zonës SEPA;

- 1.21. **transaksioni kombëtar i pagesës** - nënkupton një transaksion pagese të iniciuar nga një pagues ose përfitues pagese, ku OSHP-ja e paguesit dhe OSHP-ja e përfituesit të pagesës janë të vendosura në Kosovë;
 - 1.22. **pala referuese** - nënkupton një person fizik ose juridik në emër të të cilit një pagues bën një pagesë, ose një përfitues pagese pranon një pagesë;
 - 1.23. **BQK** - nënkupton Banka Qendrore e Kosovës;
 - 1.24. **SEPA** - nënkupton Zonën e Vetme të Pagesave në Euro;
 - 1.25. **Zona SEPA** - nënkupton shtrirjen gjeografike të skemave SEPA siç përcaktohet nga kriteret e përcaktuara nga EPC;
 - 1.26. **EPC** - nënkupton Këshillin Evropian të Pagesave;
 - 1.27. **ISO** - nënkupton Organizatën Ndërkombëtare për Standardizim;
 - 1.28. **EBA** - nënkupton Autoritetin Bankar Evropian.
 - 1.29. **Ligji për Shërbimet e Pagesave** - nënkupton Ligji Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin e mëparshëm, për qëllimet e kësaj rregulloreje dhe të çdo mase tjetër që e zbaton atë, termat e përdorur do të kenë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 4

Kërkesat për transferimin e kreditit dhe transaksionet e debitimit direkt

1. OSHP-të do të kryejnë transferta krediti dhe transaksione të debitimit direkt në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - 1.1. ata duhet të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesave të specifikuar në pikën (1)(a) të Shtojcës I për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nga vendndodhja e OSHP-së në fjalë;
 - 1.2. ata duhet të përdorin formatet e mesazheve të specifikuara në pikën (1)(b) të Shtojcës I, kur dërgojnë transaksione pagese të një OSHP-je tjetër ose nëpërmjet një sistemi pagesash me vlerë të vogël;
 - 1.3. ata duhet të sigurojnë që PShP-të të përdorin identifikuesin e llogarisë së pagesës të specifikuar në pikën (1)(a) të Shtojcës I për identifikimin e llogarive të pagesave, pavarësisht nëse OSHP-ja e paguesit dhe OSHP e përfituesit të pagesës ose e vetmja OSHP në transaksionin e pagesës ka vendndodhjen në Kosovë;
 - 1.4. ata duhet të sigurojnë që kur një PShP që nuk është konsumator ose mikrondërmarrje, inicon ose merr transferta krediti individuale ose debitime direkte individuale të cilat nuk transmetohen individualisht, por janë të grupuara për transmetim, formatet e mesazheve të specifikuara në pikën (1) (b). të Shtojcës I janë përdorur.
2. Pa cenuar nënparagrafin 1.2 të paragrafit të parë, OSHP-të, me kërkesë specifike të një PShP-je, do të përdorin formatet e mesazheve të specifikuara në pikën (1)(b) të Shtojcës I të kësaj rregulloreje në lidhje me atë PShP.

3. OSHP-të kryejnë transfertat krediti në përputhje me kërkesat e mëposhtme, duke iu nënshtruar çdo detyrimi të përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale Ligji Nr. 06/L –082:
 - 3.1. OSHP-ja e paguesit duhet të sigurohet që paguesi të sigurojë elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (2)(a) të Shtojcës I;
 - 3.2. OSHP-ja e paguesit duhet të sigurojë elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (2)(b) të Shtojcës I të OSHP-së së përfituesit të pagesës;
 - 3.3. OSHP-ja e përfituesit të pagesës duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të përfituesit të pagesës elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (2)(d) të Shtojcës I.
4. OSHP-të do të kryejnë debitime direkte në përputhje me kërkesat e mëposhtme, duke iu nënshtruar çdo detyrimi të përcaktuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:
 - 4.1. OSHP-ja e përfituesit të pagesës duhet ta sigurojë që:
 - 4.1.1. përfituesi i pagesës siguron elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (3)(a) të Shtojcës I me debitimin e parë direkt dhe debitimin direkt të njëhershëm dhe me çdo transaksion pagese të mëpasshme;
 - 4.1.2. paguesi jep pëlqimin si për OSHP-në e përfituesit të pagesës ashtu edhe për paguesin (në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet përfituesit të pagesës), mandatet, së bashku me modifikimet ose anulimet e mëvonshme, ruhen nga përfituesi i pagesës ose nga një palë e tretë në emër të përfituesit të pagesës dhe përfituesi i pagesës informohet për këtë detyrim nga OSHP-ja në përputhje me nenet 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
 - 4.2. OSHP-ja e përfituesit të pagesës duhet t'i sigurojë OSHP-së së paguesit elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (3)(b) të Shtojcës I;
 - 4.3. OSHP-ja e paguesit duhet të sigurojë ose të vërë në dispozicion të paguesit elementet e të dhënave të specifikuar në pikën (3)(c) të Shtojcës I;
 - 4.4. Paguesi duhet të ketë të drejtën të udhëzojë OSHP-në e tij:
 - 4.4.1. për të kufizuar mbledhjen e debitit direkt në një shumë ose periodicitet të caktuar ose të dyja;
 - 4.4.2. kur një mandat sipas një skeme pagese nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, për të verifikuar çdo transaksion të debitimit direkt dhe për të kontrolluar nëse shuma dhe periodiciteti i transaksionit të debitimit direkt është i barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat, para debitimit të llogarisë së tyre të pagesave, bazuar në informacionin lidhur me mandatin;
 - 4.4.3. për të bllokuar çdo debitim direkt në llogarinë e pagesave të paguesit ose për të bllokuar çdo debi direkte të inicuar nga një ose më shumë kreditorë të specifikuar ose për të autorizuar debitime direkte të iniciuara vetëm nga një ose më shumë përfitues pagese të specifikuar.
 - 4.5. Kur as paguesi dhe as përfituesi i pagesës nuk janë konsumatorë, OSHP-ve nuk u kërkohet që të jenë në përputhje me nënparagrafin 4.4, nën-nënparagrafët 4.4.1, 4.4.2 ose 4.4.3.
 - 4.6. OSHP-ja e paguesit do të informojë paguesin për të drejtat e përmendura në nënparagrafin 4.4 në përputhje me nenet 51 dhe 52 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

- 4.7. Me rastin e transaksionit të parë të debitimit direkt ose një transaksion të njehershëm të debitimit direkt dhe pas çdo transaksioni të mëpasshëm të debitimit të direkt, përfituesi i pagesës do t'i dërgojë informacionin lidhur me mandatin OSHP-së së tij dhe OSHP-ja e përfituesit të pagesës do t'ia transmetojë atë informacion në lidhje me mandatin OSHP-së së pagesit me çdo transaksion të debitimit direkt.
5. Përveç kërkesave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, përfituesi i pagesës që pranon transferta krediti do të komunikojë identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën (1)(a) të shtojcës, kur kërkohet një transferim kredie.
 6. Përpara transaksioneve të para të debitimit direkt, paguesi duhet të komunikojë identifikuesin e llogarisë së tij të pagesës të specifikuar në pikën (1)(a) të shtojcës.
 7. Kur marrëveshja kornizë ndërmjet paguesit dhe OSHP-së së paguesit nuk parashikon të drejtën e rimbursimit, OSHP-ja e paguesit, pa cenuar nënparagrafin 4.1.2 më sipër, do të verifikojë çdo transaksion të debitimit direkt për të kontrolluar nëse shuma e transaksionit të dorëzuar të debitimit direkt është e barabartë me shumën dhe periodicitetin e rënë dakord në mandat përpara debitimit të llogarisë së pagesave të paguesit, bazuar në informacionin e lidhur me mandatin.
 8. OSHP-të nuk do të kërkojnë që PShP-të të tregojnë BIC-in e OSHP-së së një paguesi ose të OSHP-së së një përfituesi të pagesës.
 9. OSHP-ja e paguesit dhe OSHP-ja e përfituesit të pagesës nuk do të vendosin tarifa shtesë ose tarifa të tjera në procesin e leximit për të gjeneruar automatikisht një mandat për ato transaksione pagese të iniciuara nëpërmjet ose me anë të një kartelet pagese në pikën e shitjes, të cilat rezultojnë në debitim direkt.

Neni 5

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

1. Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, BQK-ja ka kompetencë të ndërmerr masa korrigjuese, shqiptojë gjopa dhe ndëshkime administrative ndaj OSHP-ve, siç është përcaktuar në nenin 67 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe nenin 124 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Për çdo shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje janë të zbatueshme paragrafët 3 deri në 11 të nenit 124, të Ligjit nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 6

Procedurat e ankesës dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve

Procedurat e ankesës dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të parashikuara në nenet 120, 121, 122 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave, zbatohen për çdo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore ndërmjet PShP-ve dhe OSHP-ve të tyre.

Neni 7

Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca nr. I Kërkesat teknike (neni 4).

Neni 8

Udhëzimet

Në lidhje me masat që duhet të ndërmerren në përputhje me këtë Rregullore, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga BQK-ja, OSHP-të do t'u binden udhëzimeve përkatëse të nxjerra nga EBA.

Neni 9

Periudha kalimtare

OSHP-të që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje, do t'i përshtatin aktivitetet dhe operacionet e tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje të paktën një (1) muaj përpara aplikimit në EPC për pjesëmarrje në njëri nga skemat SEPA, por jo me tepër se periudha maksimale prej 18 muajsh – periudhë që korrespondon me periudhën kalimtare në nenin 139 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 10 ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbime të Pagesave, me përjashtim të dispozitave të ndryshuara sipas Ligjit nr. 03/L -333 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-096 për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të cilat hyn në fuqi 10 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dr.sc. Bashkim Nurboja
Kryesuesi i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

SHTOJCA I

KËRKESAT TEKNIKE (NENI 4)

- (1) Përveç kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 4, për transfertat e kreditit dhe transaksionet e debitimit direkt do të zbatohen kërkesat teknike të mëposhtme:
- (a) Identifikuesi i llogarisë së pagesës të përmendur në nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 dhe 1.3 duhet të jetë IBAN.
 - (b) Standardi për formatin e mesazhit të përmendur në nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafët 1.2 dhe 1.4 duhet të jetë standardi ISO 20022 XML.
 - (c) Fusha e të dhënave të dërgesave duhet të lejojë 140 karaktere. Skemat e pagesave mund të lejojnë një numër më të madh karakteresh, përveç nëse pajisja e përdorur për dërgimin e informacioneve ka kufizime teknike në lidhje me numrin e karaktereve, me çrast zbatohet limiti teknik i pajisjes.
 - (d) Informacionet referuese të dërgesave (remitencave) dhe të gjithë elementët e tjerë të të dhënave të siguruar në përputhje me pikat (2) dhe (3) të kësaj Shtojce I duhet të kalohen plotësisht dhe pa ndryshim ndërmjet OSHP-ve në zinxhirin e pagesave.
 - (e) Pasi të dhënat e kërkuara të jenë të disponueshme në formë elektronike, transaksionet e pagesave duhet të lejojnë një procesim plotësisht të automatizuar, elektronik në të gjitha fazat e procesit përgjatë zinxhirit të pagesave (nga fillimi deri në fund drejtpërsëdrejti përgjatë procesimit), duke mundësuar që i gjithë procesi i pagesës të kryhet në mënyrë elektronike pa pasur nevojë për rifutje të të dhënave ose ndërhyrje manuale. Kjo duhet të zbatohet gjithashtu për trajtimin e jashtëzakonshëm të transfertave të kredisë dhe transaksioneve të debitimit direkt, kurdo që është e mundur.
 - (f) Skemat e pagesave nuk duhet të vendosin asnjë kufi minimal për shumën e transaksionit të pagesës që lejon transfertat krediti dhe debitimet direkte, por nuk kërkohet të procesojnë transaksionet e pagesave me shumë zero.
 - (g) Skemat e pagesave nuk janë të detyruara të kryejnë transfertat krediti dhe debitime direkte që tejkalojnë shumën prej 999 999 999,99 euro.
- (2) Përveç kërkesave të përmendura në pikën (1), për transaksionet e transfertave të kreditit zbatohen kërkesat në vijim:
- (a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 janë si më poshtë:
 - (i) emri i paguesit dhe/ose IBAN-i i llogarisë së pagesave të paguesit;
 - (ii) shuma e transfertës së kreditit
 - (iii) IBAN-i i llogarisë së pagesave të përfituesit të pagesës;
 - (iv) kur është e mundur, emri i përfituesit të pagesës;
 - (v) çdo informacion për dërgesën.
 - (b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 janë si në vijim:
 - (i) emri i paguesit;
 - (ii) IBAN-i i llogarisë së pagesave të paguesit;
 - (iii) shuma e transfertës së kreditit
 - (iv) IBAN-i i llogarisë së pagesave të përfituesit të pagesës;

- (v) çdo informacion për dërgesën;
 - (vi) çdo kod identifikimi i përfituesit të pagesës;
 - (vii) emri i çdo pale referuese të përfituesit të pagesës;
 - (viii) çdo qëllim i transferimit të kreditit;
 - (ix) çdo kategori e qëllimit të transferimit të kreditit.
- (c) Përveç kësaj, elementët në vijim për të dhënat e detyrueshme duhet t'i sigurohen OSHP-së së përfituesit të pagesës nga OSHP-ja e paguesit:
- (i) KIB-i i OSHP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - (ii) KIB-i i OSHP-së së përfituesit të pagesës (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - (iii) kodi i identifikimit të skemës së pagesës;
 - (iv) data e shlyerjes së transfertës së kreditit;
 - (v) numri i referencës së mesazhit të transferimit të kreditit të OSHP-së së paguesit.
- (d) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 janë si në vijim:
- (i) emri i paguesit;
 - (ii) shuma e transfertës së kreditit;
 - (iii) çdo informacion për dërgesën
- (3) Përveç kërkesave të përmendura në pikën (1), kërkesat e mëposhtme zbatohen për transaksionet e debitimit direkt:
- (a) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 nënparagrafi 4.1.1 janë si në vijim:
- (i) lloji i debitimit direkt (i përsëritur, i njëhershëm, i pari, i fundit ose i kthimit);
 - (ii) emri i përfituesit;
 - (iii) IBAN-i i llogarisë së pagesave të përfituesit të pagesës që do të kreditohet për arkëtim;
 - (iv) kur është e mundur, emri i paguesit;
 - (v) IBAN-i i llogarisë së pagesave të paguesit që do të debitohet për arkëtim;
 - (vi) referenca unike e mandatit;
 - (vii) data në të cilën është nënshkruar mandati i paguesit;
 - (viii) shuma e arkëtimit;
 - (ix) kur mandati është marrë nga një kreditor tjetër përveç përfituesit të pagesës që ka lëshuar mandatin, referenca unike e mandatit siç është dhënë nga përfituesi i pagesës fillestar që ka lëshuar mandatin;
 - (x) identifikuesi i përfituesit të pagesës;
 - (xi) kur mandati është marrë nga një kreditor tjetër përveç përfituesit të pagesës që ka lëshuar mandatin, identifikuesi i përfituesit fillestar që ka lëshuar mandatin;
 - (xii) çdo informacion për dërgesat nga përfituesi i pagesës tek paguesi;
 - (xiii) çdo qëllim të arkëtimit;
 - (xiv) çdo kategori e qëllimit të arkëtimit.
- (b) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 janë si në vijim:
- (i) KIB-i i OSHP-së së përfituesit të pagesës (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);

- (ii) KIB-i i OSHP-së së paguesit (nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga OSHP-të e përfshira në transaksionin e pagesës);
 - (iii) emri i palës referuese të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - (iv) kodi i identifikimit i palës referuese të paguesit (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - (v) emri i palës referuese të përfituesit të pagesës (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - (vi) kodi i identifikimit të palës referuese të përfituesit të pagesës (nëse është i pranishëm në mandatin e dematerializuar);
 - (vii) kodi i identifikimit të skemës së pagesës;
 - (viii) data e shlyerjes së arkëtimit;
 - (ix) referenca e OSHP-së së përfituesit të pagesës për arkëtimin;
 - (x) lloji i mandatit;
 - (xi) lloji i debitimit direkt (i përsëritur, njëhershëm, i parë, i fundit ose i kthimit);
 - (xii) emri i përfituesit të pagesës;
 - (xiii) IBAN-i i llogarisë së pagesave të përfituesit të pagesës që do të kreditohet për arkëtimin;
 - (xiv) aty ku është e mundur, emri i paguesit;
 - (xv) IBAN-i i llogarisë së pagesës së paguesit që do të debitohet për arkëtimin;
 - (xvi) referenca unike e mandatit;
 - (xvii) data e nënshkrimit të mandatit;
 - (xviii) shuma e arkëtimit;
 - (xix) referenca unike e mandatit siç është dhënë nga përfituesi fillestar që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë nga një kreditor tjetër përveç atij që ka lëshuar mandatin);
 - (xx) identifikuesi i përfituesit të pagesës;
 - (xxi) identifikuesi i përfituesit të pagesës që ka lëshuar mandatin (nëse mandati është marrë nga një kreditor tjetër përveç përfituesit të pagesës që ka lëshuar mandatin);
 - (xxii) çdo informacion për dërgesat nga përfituesi i pagesës tek paguesi.
- (c) Elementet e të dhënave të përmendura në nenin 4 paragrafi 4 nënparagrafi 4.3 janë si në vijim:
- (i) referenca unike e mandatit;
 - (ii) identifikuesi i përfituesit të pagesës;
 - (iii) emri i përfituesit të pagesës;
 - (iv) shuma e arkëtimit;
 - (v) çdo informacion për dërgesën;
 - (vi) kodi i identifikimit të skemës së pagesës.